

V E N D I M
Nr.364, datë 20.5.1996

**PËR NJË SHITESË NË VENDIMIN E KËSHILLIT TË MINISTRAVE NR.107, DATË
12.2.1996 “PËR EMËRIMIN E KRYEREGJISTRUESIT TË PASURISË SË PALUAJTSHME
TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË”**

Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Në vendimin e Këshillit të Ministrave nr.107, datë 12.2.1996, pas pikës 3 shtohet pika 3/a me këtë përmbajtje:

“Pagat e punonjësve të Zyrës Qendrore të Regjistrimit të Pasurisë së Paluajtshme të jenë sipas lidhjes II-5, të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.393, datë 3.9.1992 “Për pagat e punonjësve të institucioneve buxhetore”.

2. Në vendimin e Këshillit të Ministrave nr.393, datë 3.9.1992 në lidhjen nr.1, në numrin rendor 8 dhe në lidhjen II-5 në numrin rendor 3 shtohet emërtimi:

“Kryeregjistruesi i Zyrës Qendrore të Regjistrimit të Pasurisë së Paluajtshme”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe i shtrin efektet e tij financiare nga data e emërimit të kryeregjistruesit të Pasurisë së Paluajtshme.

KRYETARI I KËSHILLIT TË MINISTRAVE
Aleksandër Meksi